

LIGJ
Nr.9321, datë 25.11.2004

**PËR PRIVATIZIMIN E BANESAVE DHE OBJEKTEVE TË KTHYERA NË BANESA, TË
NDËRTUARA ME FONDET E SHOQËRIVE DHE TË NDËRMARRJEVE SHTETËRORE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Të gjitha banesat, si dhe objektet ndërtimore të shndërruara në objekte banimi, që i kanë kaluar Entit Kombëtar të Banesave, të ndërtuara deri më 31.12.1999 dhe që janë në pronësi të shoqërive dhe ndërmarrjeve shtetërore, privatizohen për banorët aktualë të tyre, sipas kritereve të caktuara në ligjin nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, duke shumëzuar tarifën e privatizimit me indeksin e korrigjimit të çmimeve.

Neni 2

Privatizimi i banesave kryhet nga Enti Kombëtar i Banesave brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, pasi të jenë shlyer nga përfituesit detyrimet ndaj Entit Kombëtar të Banesave.

Neni 3

Ngarkohet Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore, për zbatimin e këtij ligji.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4423, datë 14.12.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu